UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
REKTORATI
Pranuar me dt. 04.11.2026
Njesia organ. | Num | Nr.Ekzem | Vlera
| 2724

UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike

Këshilli i Fakultetit Nr. Prot. 800 Dt. 04.11.2026

Në mbështetje të nenit 41 dhe 48, pika 1.9 të Rregullores nr. Prot. 3013, dt. 21.12.2023 për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë dhe plotësim rregullores me nr prot.1621, dt 26.07.2024 bazuar në konkursin e UIBM-së nr. prot 2357, dt. 05.10.2026 për zgjedhjen, rizgjedhjen dhe avancimin e personelit akademik në fakultetet e Universitetit "Isa Boletini", Këshilli i Fakultetit i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike në mbledhjen e mbajtur më 04.11.2026 nxjerr këtë;

K O N S T A T I M

1. Këshilli i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike shqyrtoi dhe konstatoi kryerjen e punëve në lidhje me raportin e komisionit recensues të formuar nga Këshilli i Fakultetit në mbledhjen e mbajtur më 14.10.2026.

2. Këshilli i Fakultetit konstaton se raporti i komisionit recensues për pozitën III.1 zgjedhje për herë të parë në thirrjen përkatëse është i kompletuar dhe i përcjellë në zyrën për çështje akademike të Universitetit "Isa Boletini" - Mitrovicë për publikim në Buletin, sipas afateve të përcaktuara në Rregulloren nr. Prot. 3013, dt. 21.12.2023 për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë dhe plotësim rregullores me nr. prot. 1621, dt 26.07.2024 për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë.

Bashkangjitur gjeni:
Raportin e Komisionit vlerësues për një mësimdhënës nga fusha e Inxhinierisë Mekanike për lëndët: "Teknikat Matëse", "Detalet e Makinave I", "Detalet e Makinave II", "Detalet e Makinave me Konstruksione" dhe "Sistemet Hidraulike dhe Pneumatike".

I dorëzohet:
Zyrës për çështje akademike
Sekretarit të FIMK-ut,
Arkivit të fakultetit,

Kryesuesi i Këshillit
Prof. Asoc. Dr. Faruk Ahmeti

Rr. Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
http://www.umib.net; info@umib.net; Tel: +383-28/515516 – lokali 4

UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
REKTORATI
Pranuar me dt: 04.11.2026
Njesia orga | Num | Nr.Ekzem | Vlera
272412

UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE
DHE KOMPJUTERIKE
Pranuar me dt: 29.10.2026
Njesia organ. | Numer | Nr.Ekzempl. | Vlera
750

UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË

RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES

Fakulteti:	**Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe kompjuterike**
Lënda/ët për të cilat është shpallur konkursi:	**Teknikat matëse, Detalete makinave I, Detalet e makinave II, Detalet e makinave me konstruksione, Sistemet hidraulike dhe pneumatike.**
Kandidatët e paraqitur:	1.Dr sc Arben **AVDIU**

Komisioni vlerësues:

1. Kryetar	**Prof Asoc dr. Fatmir Azemi**
2. Anëtar	**Prof Ass dr. Luan Mulaku**
3. Anëtar	**Prof Ass dr. Granit Hajra**

Shënimet për kandidatin/en për të cilin/ën shkruhet raporti
Kandidati

Emri dhe mbiemri	*Arben AVDIU*
Datëlindja	*20.12.1975*
Vendlindja	*Prishtine*
Grada shkencore	*Doktor shkence ne Inxhinieri mekanike*
Arsimimi i lartë	
Studimet e Doktorates	
-Universiteti/Fakulteti	*Nigde OmerHalisdemir University*
-Departamenti:	*Faculty of Mechanical Engineering*
-Titulli i fituar	***Doktor shkencave ne Inxhinieri mekanike***
-Viti i doktorimit	***06.06.2022***
-Nota mesatare:	*N/A*
-Nnostrifikimi nëse ka studiuar jashtë vendit:	***Nr 2/6-588, 25/01.2023***
Studimet Master/Magjistraturë	
-Universiteti/Fakulteti	***Universiteti i Prishtines/Fakulteti i Inxhiniersë Mekanike***
-Departamenti	*Termoenergjetike dhe Termoteknik*
-Titulli i fituar	*Master shekncor ne Inxhinieri mekanike*
-Viti i Diplomimit	*04.11.2008*
- Nota mesatare	*N/A*
-Nnostrifikimi nëse ka studiuar jashtë vendit	-
Studimet Themelore	
-Universiteti/Fakulteti	***Universiteti i Prishtines / Fakulteti i Inxhiniersë Mekanike***
-Departamenti	*Makineri Prodhuese*
-Titulli i fituar	*Inxhinier i diplomuar i makinerise*
-Viti i Diplomimit	*25.06.2003*
- Nota mesatare	*N/A*
-Nostrifikimi nëse ka studiuar jashtë vendit	-

Sqarim: Në këtë tabelë paraqiten shënimet për secilin kandidat që i shkruhet raporti. Të shtohen tabela, varësisht nga numri i kandidatëve. Për pozitën profesor, komisioni vlerëson fushën e ngushtë nga studimet, Bachelor, Master dhe të Doktoratës (është obligative që të tri nivelet të jenë të fushës përkatëse sipas konkursit), ndërsa për pozitën asistent/e, studimet bachelor dhe master.

1. Përmbledhje e aktivitetit shkencor të kandidatit/es

Tabela I: Punimet e publikuara në revista, të cilat janë të indeksuara në platformat- databazat akademike, sipas Rregullores me nr. prot. 3013 dt.21.12.2023 për procedurat e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren nr. prot. 1621 të dt. 26.07.2024, Vendimin e Senatit me nr.prot.1757 të dt.06.08.2024 dhe Vendimin e Senatit me nr.prot. 79 të dt. 14.01.2025.

Nr	Autori/ët	Titulli i punimit	Platforma	Revista	Impa Faktori	Viti vëllimi, nr., faqet	Linku identifikues[1]
1	**Arben Avdiu** B Dragusha, R Selimaj, Drilon Meha	**Evaluating the Performance of Solid Oxide Fuel Cells with Convergent and Divergent Flow Channel Designs**	**Web of science** Scopus	Jordan Journal of Mechanical and Industrial Engineering	-	Volume 20, Number 3, September 2026	https://jjmie.hu.edu.jo/vol20/vol20-3/10-JJMIE-426-25.pdf
2							
3							

***Sqarim:** Autor i parë konsiderohet personi, emri i të cilit gjendet i pari në listën e autorëve. Autori korrespodent konsiderohet autori i punimit, i cili shprehimisht është përcaktuar si i tillë në punim. Nëse në punimin e publikuar janë specifikuar më shumë se 1 (një) autor korrespondent, si autor korrespondent konsiderohet autori i parë i identifikuar si i tillë. Nëse në punimin e publikuar janë vetëm dy autorë dhe autori korrespondent nuk është specifikuar, autori i dytë konsiderohet si autor korrespondent.*

Në këtë tabelë duhet të radhiten vetëm punimet që i plotësojnë kriteret e përcaktuara në Statutin e UIBM -së dhe Rregullores me nr. prot. 3013 dt.21.12.2023 për procedurat e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren nr. prot. 1621 të dt. 26.07.2024, Vendimin e Senatit me nr.prot.1757 të dt.06.08.2024 dhe Vendimin e Senatit me nr.prot. 79 të dt. 14.01.2025.

Komisionit vlerësues mbajnë përgjegjësi lidhur me saktësinë e informatave për punimet e radhitura në këtë tabelë.

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën I.

(Komisioni vlerësues duhet të ofrojë informata për tipin e publikimeve, për revistën në të cilën ka botuar autori duke iu referuar statusit të kandidatit/es në kuadër të punimit (p.sh. autor i parë etj), "impakt faktorin" e revistës, shtëpinë botuese, ORCID ID etj. Komisioni duhet të precizojë burimin e informatave në të cilin është mbështetur dhe i cili mund të verifikohet. Argumentet relevante për të dhënat dhe burimet mbështetëse për të dhënat e paraqitura duhet të bashkëngjiten në këtë raport).

Kandidati ka të botuara **1 punim** Autor i parë në revist të indeksuara sipas kritereve te përcaktuara në Statutin e UIBM–it dhe Rregulloret e UIBM-ë. Punimi eshte i indeksuar ne platformën **SCOPUS** dhe **WEB OF SCIENCE**.

Revista: Jordan Journal of Mechanical and Industrial Engineering

1. https://jjmie.hu.edu.jo/vol20/vol20-3/10-JJMIE-426-25.pdf

Web of Science ResearcherID: **C-3540-2019**

2. Kandidati është bashk-autor në 3 punime shkencore.

[1] Komisioni vlerësues është i obligiuar të shënojnë linkun nëpërmjet të të cilit dëshmohet indeksimi i punimit përkatësisht revistës në bazën e caktuar akademike, respektivisht linkun e punimit në revistën përkatëse

2. Përvoja në mësimdhënie universitare

(Në këtë pjesë të raportit shënohen gradat paraprake shkencore dhe titujt akademikë të kandidatit/es, universitetet ku ai/ajo ka punuar, programet akademike, kualifikimet, angazhimi në institucione jashtë vendit etj. Argumentet relevante për të dhënat dhe burimet mbështetëse për të dhënat e paraqitura, duhet të bashkëngjiten në këtë raport).

Periudha: Nga 17.04.2004, Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
Pozita: Asistent i laboratorit - Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësive:

I angazhuar në udhëzimin dhe mbikëqyrjen e studentëve gjatë zhvillimit të punëve laboratorike në fushën inxhinierisë mekanike, termoenergjisë dhe burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Ofrimi i shembujve të simulimeve numerike, realizimi i matjeve të ndryshme me pajisje dhe instrumente përkatëse, si dhe mbështetja e studentëve në zbatimin praktik të njohurive teorike gjatë punës laboratorike.

Tabela II. Publikimet e monografive, librave, kapitujve të librave dhe dispensave,

Nr	Autori/ët	Titulli i publikimit	Shtëpia botuese, vendi, viti	Numri ISBN
1	Arben **AVDIU**	**Flow field design and optimization for solid oxide fuel cell**	Artini, Prishtina 2026	**MONOGRAFI** **CIP** 621.352.6:519.6 **ISBN** 978-9951-28-678-7
2				

Anëtarët e Komisionit vlerësues mbajnë përgjegjësi lidhur me saktësinë e informatave të radhitura në tabelën III.

Tabela III. Publikimet nga kongreset dhe konferencat në nivel ndërkombëtar dhe vendor

Nr	**Autori/ët**	**Titulli i punimit**	**Emërtimi i kongresit, konferenca,**	**Vëllimi, nr., faqet, viti (të dëshmuara me proceedings book, botimi i përmbledhjes së abstrakteve ose agjenda)**
1				
2				

Tabela IV. Pjesëmarrja në Komitetet shkencore në kongreset dhe konferencat në nivel ndërkombëtar dhe vendor

Nr	**Emërtimi i kongresit, konferencës**	**Linku /libri i publikimeve**
1		
2		

Tabela V. Pjesëmarrja në komisionet vlerësuese për zgjedhje dhe avancim të stafit akademik

Nr	Pozitat e konkursit	Pozita në komision	Viti
1			
2			
3			

Tabela VI. Mentorimi i temave të diplomës

Nr	Emri Mbiemri (i kandidatit/es)	Niveli i studimit	Viti i përfundimit
1			
2			

Sqarim: Plotësohet tabela me emrat e kandidatëve pas thirrjes së fundit.

Tabela VII. Ligjëratat-prezantimet, ligjërues/e i/e ftuar në universitet dhe punëtori shkencore nga lëmia e kandidatit/es

Nr	Autorët (renditja si në Ligjëratë/Prezantim)	Titulli i ligjëratës/prezantimit	Lloji i ligjëratës/prezantimit (Universiteti, Punëtori shkencore)	Viti, Vendi
1				
2				

Tabela VIII. Redaktor/e -Recensent/e në revistat akademike apo shkencore

Nr	Kontributi (redaktore-recensent/e)	Autori/ët e punimit	Titulli i punimit të recensuar	Revista e cila është redaktuar ose për të cilën është shkruar recensioni	Vendi, Viti
1					
2					
3					

Tabela IX. Trajnimet profesionale

Nr	Trajnimi (Titulli i trajnimit)	Certifikata	Viti
1	PCMLBS	VIESMANN	2013
2	WELDING	CERTIFICATE OF PARTICIPATION	2017
3	FREIBERG	ZERTIFICATE	2001

Tabela X. Angazhimi në projekte

Nr	Lloji	Emri i projektit	Pozita në projekt	Kohëzgjatja
1				
2				

3. Përvoja menaxhuese, angazhimet profesionale dhe udhëheqja në hulumtim

(Në këtë pjesë të raportit shënohen pozitat dhe funksionet udhëheqëse, angazhimet profesionale në hulumtimet shkencore dhe projektet e tjera në të cilat ka marrë pjesë kandidati, programi prej të cilit është financuar projekti, çmimet dhe mirënjohjet, kualifikimet e ndryshme, patentat, inovacioni etj. Argumentet relevante për të dhënat dhe burimet mbështetëse për të dhënat e paraqitura duhet të bashkëngjiten në këtë raport).

Moduli: **Trajnim profesional për testimin Blower Door dhe termografinë.**
Institucioni organizues: **Indoor Climate Research & Training, Applied Research Institute, University of Illinois, SHBA.** Periudha e trajnimit: 17.06.2019 – 28.06.2019.
Kualifikimi i fituar: **Certifikatë në fushën e Efiçiencës së Energjisë dhe Menaxhimit të Energjisë në Industri dhe Ndërtesa.**
Lëndët kryesore dhe kompetencat profesionale të fituara:
Trajnimi përfshiu ligjërata teorike dhe punë praktike në fushën e efiçiencës së energjisë, me fokus në sistemet e ngrohjes, ventilimit dhe klimatizimit (HVAC), auditimin energjetik në industri, pajisjet dhe teknikat e matjes, burimet e ripërtëritshme të energjisë, si dhe menaxhimin e energjisë në ndërtesa dhe objekte industriale.
Temat e trajtuara përfshinë gjithashtu sistemet e kogjenerimit dhe rikuperimit të nxehtësisë, analizën ekonomike të investimeve, efiçiencën energjetike të motorëve elektrikë, izolimin termik, sistemet me pompa termike, optimizimin e konsumit të energjisë në sistemet e avullit, ajrit të kompresuar dhe pompimit të ujit. Trajnimi përfshiu edhe zbatimin e metodave të testimit Blower Door dhe termografisë për vlerësimin e performancës energjetike të ndërtesave.
Pjesë e programit ishin edhe vizitat studimore në laboratorë të ndriçimit, fabrika të prodhimit të qelqit dhe objekte industriale, përfshirë fabrikën e sistemeve të klimatizimit Mitsubishi. Këto aktivitete mundësuan përvetësimin e njohurive praktike mbi teknologjitë bashkëkohore, metodat e matjes dhe vlerësimit të konsumit energjetik, si dhe zbatimin e masave për përmirësimin e efiçiencës së energjisë në ndërtesa dhe industri.

Programi i 19-të Ndërkombëtar i Trajnimit për Efiçiencën dhe Menaxhimin e Energjisë në Industri dhe Ndërtesa. Institucionet organizatore:

- Ministria e Energjisë dhe Burimeve Natyrore e Republikës së Turqisë;
- Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TİKA);
- Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA).

Vendi i realizimit: **Ankara, Republika e Turqisë**. Periudha: 01.04.2018 – 23.11.2018.
Niveli i klasifikimit: **Ndërkombëtar**.
Institucioni përgjegjës: **Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA), Tokio, Japoni**.

4. Mobiliteti i kandidatit

(Në këtë pjesë të raportit shënohen universitetet në të cilat ka studiuar kandidati/ja, si dhe institucionet e tjera në të cilat ai/ajo ka qëndruar për qëllime pedagogjike shkencore, qëndrime hulumtuese jashtë vendit etj. Argumentet relevante për të dhënat dhe burimet mbështetëse për të dhënat e paraqitura duhet të bashkëngjiten në këtë raport).

Kandidati studimet e Doktoratës i ka përfunduar në Republikën e Turqisë, ku edhe ka qendruar në NİĞDE ÖMER HALİSDEMİR UNIVERSITY.

5. Vlerësimi i kandidatit/es në intervistë (në rastet e krijimit të marrëdhënies së punës për herë të parë)

(Në këtë pjesë të raportit, komisioni duhet të ofrojë të dhëna të sakta dhe të plota, sipas pikës 2 të nenit 167 të Statutit të UIBM dhe Rregullores me nr. prot. 3013 dt.21.12.2023 për procedurat e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren nr. prot. 1621 të dt. 26.07.2024, Vendimin e Senatit me nr.prot.1757 dt.06.08.2024 dhe Vendimin e Senatit me nr.prot. 79 të dt. 14.01.2025.)

Kandidati i paraqitur: 1. Dr sc Arben **AVDIU,** gjatë **intervistës** ka treguar se ka aftësi pedagogjike, gjithashtu posedon aftësi të mësimëdhënjes dhe ka pervojën e duhur në arsim e lartë. Gjithashtu ka treguar kompetencë për përshtatshmërin me lëndët për të cilat është shpallur konkursi. Po ashtu kandidati ka kryer edhe disa trajnime në Universietetin e Prishtinës **Teaching in higher education** - 2021 dhe **Planning and implementation of teaching in higher education** (Advanced module - 2022).

6. Përfundimi dhe propozimi (titulli i cili propozohet)

(Anëtarët e Komisionit vlerësues janë të obliguar që të shkruajnë një arsyetim për titullin i cili propozohet. Ata janë të obliguar që të paraqesin në mënyrë të qartë propozimin e tyre për çdo kandidat/e. Kjo pjesë e raportit është e përbashkët për të gjithë kandidatët, ndërsa katër kapitujt paraprakë shkruhen për secilin kandidat veç e veç (për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet për aplikim sipas Statutit dhe konkursit).

Përfundimi:

Komisioni vlerësues, i formuar me Vendimin e Këshillit të Fakultetit të Inxhinierise Mekanike dhe Kompjuterike të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, me Nr. Prot. 705 të datës 14.10.2026, duke u bazuar në nenin 170 të Statutit të UIBM-së pika 1, në nenit 7, 10, 11 dhe 12 të Rregulloreve për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik në UIBM, me Nr. Prot. 313 të datës 21.12.2023, dhe plotesim rregullores Nr. Prot. 1621 të datës 26.07.2024. Bazuar në konkursin publik të shpallur me datën 05.10.20226, Nr. Prot. 2212, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të kandidatëve si dhe intervistimit, konstaton se:

Kanditati Dr sc. Arben **AVDIU** ka të përfunduara studimet e doktoratës në *Universiteti Nigde OmerHalisdemir* ku ka marrë titullin Doktor i shkencave ne Inxhinieri mekanike. Studimet e Dokotorates, i ka të përfunduar në *Fakultetin e Inxhiniersë, departamenti i ixhinierise Mekanike.*

Komisioni pas shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit, i propozon Këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike që të zgjedhë në pozitën e mësimdhënsit, kandidatin Dr. sc Arben **AVDIU**, duke u bazuar në:

Plotësimin e të gjitha kushteve:

- Kandidati ka të përfunduar studimet: Inxh i dipl, Master dhe Doktoratës në Inxhinieri mekanike dhe fusha e tij përkon me lëndët për të cilat është shpallur konkursi.
- Kandidati ka të publikuar 1 punim shkencore të indeksuar në databazat e pranuara nga UIBM, ku janë verifikuar se janë të indeksuar në **Web of Sciense** dhe **Scopus**.
- Kandidati e ka të publikuar monografinë me **ISBN 978-9951-28-678-7.**
- Kandidati ka dorëzuar të gjtha dokumentet sipas kërkesës së konkursit.

Propozimi: <u>zgjedhje për herë të parë në thirrjen përkatëse</u>:

Komisioni vlerësues i **propozon** Këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike të UIBM, që kandidati Dr. sc. Arben **AVDIU** të emërohet në pozitën **<u>profesor asistent</u>** për lëndët: **Teknikat matëse, Detalete makinave I, Detalet e makinave II, Detalet e makinave me konstruksione, Sistemet hidraulike dhe pneumatike**.

Nënshkrimet origjinale nga anëtarët e Komisionit vlerësues:
[*të shënohet thirrja e saktë akademike*]

1. Prof. Asoc Dr. Fatmir **Azemi**

_____

2. Prof. Ass Dr. Luan **Mulaku**

_____

3. Prof Ass Dr. Granit **Hajra**

_____

Datë: 29.10.2026